



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Departamenti i Prokurimit

Podujevë: datë, 27.01.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Podujevës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.01.2020, të parashtruar nga konsorciumi “Eing Com” & “El – Bau” nga Podujeva, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 2020 dhe 2021” me Nr. të Prok: 615199061211,- nr. i brendshëm 61519146211 nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e konsorciumit “Eing Com” & “El – Bau” të dt. 23.01.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 2020 dhe 2021”, me Nr. 615199061211 Nr. Brendshëm 61519146211, kundër *Njoftimit mbi vendimin e AK –së*, të datës 21.01.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. **Vërtetohet** vendimi i AK për *dhënien e kontratës* të publikuar me datë: 21.01.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit ;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Konsorciumi “Eing Com” & “El – Bau” me datë 23.01.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 2020 dhe 2021”, me Nr. të Prok: 615199061211 ; me Nr. të brendshëm të prokurimit: 61519146211. Autoriteti Kontraktues, me datë 27.01.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

AK pas analizimit të pretendimeve ankomire konstatoi si të pabazuar kërkesën për ri-shqyrtim me arsyetimin:

- Se, OE fitues i plotësojnë të gjitha kushtet e kërkuara sipas dosjes së tenderit

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorezohet brenda 5 (pesë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Rasim Fejza
menaxher i Prokurimit

